


TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE DHE NDËRMARRJET

2018



TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE DHE NDËRMARRJET



2018

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
------------	---

1.KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE

6

A.Tregia e jashtme e mallrave.....	6
B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve.....	6
C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore.....	8
D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë.....	8

2.TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2013-2017

9

A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes.....	9
B. Sektorët mbizotërues në eksportet/importet e mallrave.....	10
C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve.....	10
D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese.....	11
E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere.....	11

ANEKSI 1.....

12

Metodologji.....	12
------------------	----

HYRJE

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi eksportet/importet e mallrave në Shqipëri, si edhe statistika të tregtisë së mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve përmbajnë informacion thelbësor mbi ndërmarrjet të cilat marrin pjesë në tregun ndërkombëtar dhe karakteristikat e tyre si vlerat e eksporteve/importeve dhe numri i ndërmarrjeve. Nëpërmjet lidhjes së statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave me statistikat e ndërmarrjeve kuptojmë kontributin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë si dhe pjesëmarrjen e ndërmarrjeve e vogla, të mesme dhe të mëdha në transaksionet tregtare. Hartimi i statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve kryhet përmes lidhjes në nivel individual të të dhënave të tregtisë së mallrave me regjistrin statistikor të ndërmarrjeve. Karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve nga regjistri statistikor i ndërmarrjeve – si aktiviteti ekonomik dhe numri i të punësuarve – janë të kombinuar me variablat tipikë të të dhënave të tregtisë së mallrave si kodi i produktit dhe vendi partner, duke na dhënë në këtë mënyrë një pamje më të plotë të strukturës së tregtisë së mallrave. Duke iu referuar periudhës 2013-2017, statistikat në lidhje me tregtinë e mallrave në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e tregtisë së vendin tonë me botën.

Ky material, i përgatitur nga INSTAT, publikohet për herë të parë i strukturuar në këtë mënyrë, duke përfshirë të dhënat për vitet referencë 2013-2017 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore. Materiali përbëhet nga dy kapituj. Kapitulli i parë paraqet informacion mbi shkëmbimin e mallrave ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera të botës. Kapitulli i dytë ka për objektiv të paraqesë statistika mbi tregtinë e jashtme të mallrave të detajuar sipas kategorive të ndryshme të ndërmarrjeve.

GJETJET E PUBLIKIMIT

Në vitin 2017 eksportet e mallrave janë 273 miliard lekë, duke u rritur 12,1 % krahasuar me vitin 2016. Ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 626 miliard lekë, duke u rritur 8,1 % krahasuar me vitin 2016.

Në vitin 2017 pesha e eksporteve në vendet e BE është 77 % të eksporteve të mallrave, duke arritur vlerën 211 miliard lekë. Eksportet në vendet e BE u rritën me 11,0 % krahasuar me vitin 2016.

Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE është 62 % të importeve të mallrave, duke arritur vlerën 386 miliard lekë. Importet nga këto vende u rritën me 5,4 %, krahasuar me vitin 2016.

Në vitin 2017 partneri ynë kryesor për eksportet dhe importet vazhdon të jetë Italia. Vlera e eksporteve drejt Italisë është 146 miliard lekë, duke u rritur 9,9 % krahasuar me vitin 2016. Ndërsa vlera e importeve nga Italia 179 miliard lekë, duke u rritur 5,7 % krahasuar me vitin 2016.

Numri i ndërmarrjeve eksportuese në vitin 2017 është 2.961, duke u rritur me 8,1 % krahasuar me vitin 2016.

Në vitin 2017, numri i ndërmarrjeve importuese është 10.709 ndërmarrje, duke u rritur me 6,7 % krahasuar me vitin 2016.

Në vitin 2017, ndërmarrjet që operojnë në industri dominojnë ndërmarrjet eksportuese. Këto ndërmarrje kryejnë 82 % të vlerës së eksporteve, duke u rritur me 11,2 %, krahasuar me vitin 2016.

Ndërmarrjet që operojnë në tregti dominojnë ndërmarrjet importuese në vitin 2017. Këto ndërmarrje kryejnë 55 % të vlerës së importeve, duke u rritur me 6,4 % krahasuar me vitin 2016.

Për vitin 2017, më shumë se gjysmën e eksporteve e kryejnë 50 ndërmarrjet më të mëdha (55 %), ndërsa më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 200 ndërmarrjet më të mëdha (52 %).

Në vitin 2017, dominojnë ndërmarrjet që eksportojnë drejt 1 vendi partner. Ato kryejnë 36 %, të vlerës së eksporteve, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vendeve partnere (18 %).

Në vitin 2017, dominojnë ndërmarrjet që importojnë nga 10 ose më shumë vende partnere. Këto ndërmarrje kryejnë 50 % vlerës së importeve, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 3-5 vende partnere (17 %).

KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE

A. Tregia e jashtme e mallrave



Gjatë periudhës 5-vjeçare (2013-2017) vihet re një tendencë rritje e eksporteve dhe importeve. Në vitin 2017 pesha e eksporteve është 30 %, duke u rritur 12,1 % krahasuar me vitin 2016. Ndërsa pasha e importeve në vitin 2017 është 70 %, duke u rritur 8,1 % krahasuar me vitin 2016.

B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve

PRODUKTET KRYESORE

Produktet që zënë pjesën më të madhe të eksporteve dhe importeve shqiptare, për periudhën 5-vjeçare, janë mallra të përpunuara.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e jashtme të mallrave



- Naftë bruto
- Suprinat e veshjeve të këmbëve prej materialeve të tjera, jo prej lëkure
- Xeherorë dhe koncentre kromi
- Ferro-krom që përmban më shumë se 6% karbon
- Shufra dhe shkopinj të tjerë prej gize dhe çeliku jo të lidhur që përmbajnë dhëmbëzime, brazda, flanxha , etj

Tab.1 Eksportet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4)

milionë lekë					
Grup produktet	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	246,397	255,759	243,183	243,498	272,988
Ushqime dhe kafshë të gjalla	9,752	11,831	15,599	19,167	24,488
Pije dhe duhan	1,226	1,187	1,031	1,598	1,485
Materiale të përpunuara	26,583	22,897	22,102	23,289	23,141
Lëndë djegëse	76,366	64,569	45,090	27,397	23,902
Yndyrna bimore dhe shtazore	221	91	117	225	243
Produkte kimike	1,854	2,371	2,872	3,060	3,382
Mallra të përpunuara	47,137	52,409	49,657	44,276	57,828
Makineri e pajisje transporti	8,225	9,203	10,794	11,255	15,118
Mallra të tjera të përpunuara	74,828	90,713	95,751	112,660	123,156
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	204	489	169	571	243

Grup produktet që dominojnë importin për vitin 2017 janë: "Mallra të përpunuara" me 38 %, duke u rritur me 4,0 % krahasuar me vitin 2016, "Makineri dhe pajisje transporti" me 21 %, duke u rritur me 3,9 % krahasuar me vitin dhe "Ushqime dhe kafshë të gjalla" me 13 %, duke u rritur 6,3 % krahasuar me vitin 2016.

Në vitin 2017, grup produktet më të eksportuarar janë: "Mallra të përpunuara" me 66 %, duke u rritur me 15,3 % krahasuar me vitin 2016, "Ushqime dhe kafshë të gjalla" me 9 % të eksporteve, duke u rritur me 27,8 % krahasuar me vitin 2016 dhe "Lëndët djegëse" me 9 %, duke u ulur me 12,8 % krahasuar me vitin 2016.

Tab.2 Importet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4)

milionë lekë					
	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	517,378	552,281	544,606	579,248	626,181
Ushqime dhe kafshë të gjalla	66,829	70,111	72,759	73,616	78,268
Pije dhe duhan	19,110	15,996	16,080	18,343	20,272
Materiale të përpunuara	13,065	20,680	13,954	12,180	18,926
Lëndë djegëse	88,504	85,538	56,641	46,945	61,711
Yndyrna bimore dhe shtazore	5,293	5,723	5,807	5,562	5,202
Produkte kimike	59,825	63,657	64,471	68,618	74,302
Mallra të përpunuara	111,527	120,169	126,422	144,207	146,820
Makineri e pajisje transporti	95,240	103,089	114,024	126,677	131,630
Mallra të tjera të përpunuara	57,720	67,025	74,268	82,390	88,874
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	266	293	180	710	176

C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore

Në vitin 2017 pesha e eksporteve në vendet e BE është 77 %, duke u rritur me 11,0 % krahasuar me vitin 2016. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE është 62 % duke u rritur me 5,4 %, krahasuar me vitin 2016.


Pesha e eksporteve në vendet e CEFTA-s është 15 %, duke u rritur me 22,7 % krahasuar me vitin 2016. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e CEFTA-s është 8 % duke u rritur me 29,7 %, krahasuar me vitin 2016.

D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë

TENDENCA E PARTNERËVE TREGTARË, 2017

Eksportet në vlerë kanë shënuar rritje të konsiderueshme drejt Italisë, Kosovës dhe Spanjës. Ndërsa rritje për importet kanë Italia, Turqia, Greqia dhe Serbia.


Fig.2 Tregtia e mallrave sipas grupvendeve




Në vitin 2017 partnerët tanë kryesorë për eksportet janë: Italia (53 %), duke u rritur me 9,9 % krahasuar me vitin 2016, Kosova (8 %), duke u rritur 26,0 % krahasuar me vitin 2016, Spanja (5 %), duke u rritur 87,5 % krahasuar me vitin 2016.

Ndërsa partnerët kryesorë për importet janë: Italia (29 %), duke u rritur 5,7 % krahasuar me vitin 2016, Turqia (8 %), duke u rritur 11,2 % krahasuar me vitin 2016, Gjermania (8 %), duke u ulur 7,7 % krahasuar me vitin 2016.

Partnerët kryesorë për eksportet



Partnerët kryesorë për importet




2

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2013 - 2017


A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes

Në periudhën 2013-2017, numri i ndërmarrjeve eksportuese dhe importuese është rritur. Numri i ndërmarrjeve eksportuese, në vitin 2017, është 2.961, duke u rritur me 8,1 % krahasuar me vitin 2016. Në vitin 2017, pesha e ndërmarrjeve eksportuese mikro, të vogla dhe të mesme, është 96 %. Pesha për ndërmarrjeve mikro është 46 %, ndërmarrjet e vogla është 35 %, ndërmarrjet e mesme është 16 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 4 %.



Në vitin 2017, numri i ndërmarrjeve importuese është 10.709 ndërmarrje, duke u rritur me 6,7 % krahasuar me vitin 2016. Peshat e ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme është 98 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej. Pesha për ndërmarrjet mikro (1-9 të punësuar) është 66 %, ndërmarrjet e vogla është 24 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej, ndërmarrjet e mesme është 8 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 2 %.

Fig.3 Ndërmarrjet, sipas madhësisë së ndërmarrjes




B. Sektorët mbizotërues në eksportet/importet e mallrave

Industria përfshin: Industri nxjerrëse; Industri përpunuese; Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar; Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Për periudhën 2013-2017, në ndërmarrjet eksportuese mbizotërojnë, ndërmarrjet që operojnë në sektorin e industrisë. Në vitin 2017, pesha e eksporteve të kryera nga ndërmarrjet që operojnë në industri është 82 %, duke u rritur me 11,2 %, krahasuar me vitin 2016. Ndërmarrjet e mëdha zënë 44 % të vlerës së eksporteve të këtyre ndërmarrjeve, duke u rritur me 8,7 %, krahasuar me vitin 2016.

Për periudhën 2013-2017, vlerën më të madhe të importeve e kanë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e tregtisë. Në vitin 2017, pesha e këtyre ndërmarrjeve është 55 %, duke u rritur me 6,4 % krahasuar me 2016. Në 2017, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme zënë 93 % të vlerës së importeve të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e tregtisë, duke u rritur me 6,2 %, krahasuar me vitin 2016.


Fig 4. Tregtia e jashtme e mallrave sipas sektorëve, 2017



C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve

“Produktet nga përpunimi”, në periudhën 2013-2017 zënë pjesën më të madhe të produkteve të eksportuara dhe të importuara. Në vitin 2017, pesha e eksporteve të këtyre produkteve është 83 %, duke u rritur me 21,9 %, krahasuar me 2016. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet e veshjeve” dhe “Produktet e përpunimit të lëkurës” (26 %), si edhe “Produktet e metaleve bazë” (13 %). Ndërsa pesha e importeve të produkteve nga përpunimi është 89 %, duke u rritur me 4,8 %, krahasuar me 2016. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet ushqimore” (11 %) dhe “Kimikatet dhe produktet kimike” (8 %).

Fig.5 Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve, 2017 (%)



D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese

Në periudhë 2013-2016, më shumë se gjysma e importeve ishte e përqëndruara në 10-50 ndërmarrjet më të mëdha. Për vitin 2017, më shumë se gjysmën e eksporteve e kryejnë 50 ndërmarrjet më të mëdha (55 %). Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 52 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 69 %,

Në periudhë 2013-2016, më shumë se gjysma e importeve ishte e përqëndruara në 50-100 ndërmarrjet më të mëdha. Për vitin 2017, më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 200 ndërmarrjet më të mëdha (52 %). Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 63 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 41 %,

E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere

Në periudhë 2013-2017, pjesën më të madhe të eksporteve ndërmarrjet e kryejnë vetëm me 1 vend partner. Në vitin 2017, pesha e eksporteve të këtyre ndërmarrjeve është 36 %, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vendeve partnere (18 %). Ndërsa pjesën më të madhe të importeve, në periudhë 2013-2017, ndërmarrjet e kryejnë me 10 ose më shumë vende partnere. Në vitin 2017, pesha e importeve të këtyre ndërmarrjeve është 50 %, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 3-5 vende partnere (17 %).

Fig.6 Tregtia e jashtme e mallrave sipas ndërmarrjeve kryesore, 2017





Fig.7 Tregtia e jashtme e mallrave sipas numrit të vendeve partnere me të cilët kryejnë tregtinë ndërmarrjet, 2017



ANEKSI 1


METODOLOGJI

Burimi i informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është burimi i të dhënave të tregtisë së jashtme të mallrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është burimi i të dhënave për Regjistrin e Ndërmarrjeve.

Grumbullimi i të dhënave

Në nivelin konceptual, metodologjia e përdorur në grumbullimin dhe vlefshmërinë e të dhënave mund të shpjegohet sipas skemës në vazhdim:



Përkufizime / Koncepte

Përkufizimet dhe konceptet në këtë shpjegues metodologjik janë dhënë në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë lidhjen ndërmjet përmbajtjes së të dhënave të tregtisë së mallrave dhe regjistrit të ndërmarrjeve.

Ndërmarrja është: “kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)”. Marrëdhënia ndërmjet një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: “ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisish ligjore”.

Vendi partner në termat e eksporteve është vendi i destinacionit final të mallrave. Për importet është vendi i origjinës së mallrave.

Vendet anëtare të BE – Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Gjermani, Hollandë, Hungari, Irlandë, Itali, Kroaci, Letoni, Lituan, Luksemburg, Maltë, Mbretëri e Bashkuar, Poloni, Portugali, Qipro, Republika Çeke, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi;

Vendet anëtare të CEFTA – Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedoni, Moldavia, Serbia, Shqipëria;

Vendet anëtare të EFTA – Island, Norvegji, Lihtenshtein, Zvicër.

Eksportet janë vlerësuar me FOB (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin edhe shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit, tek një port i caktuar i ngarkimit). Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksporuara pas përpunimit aktiv.

Importet janë vlerësuar me CIF (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin sigurimin dhe transportin, deri tek një port i caktuar destinacion).

Klasifikime

Në përpunimin e informacionit statistikor të tregtisë së jashtme të mallrave mallrave, import-eksportet, është përdorur Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë (SITC), i cili i klasifikon mallrat sipas fazave të tyre të prodhimit. Ndërsa për aktivitetet klasifikimi i aktiviteteve ekonomike NVE rev.2 (emërtimi shkurt në anglisht – NACE Rev.2) dhe për produktet klasifikimi statistikor i produkteve sipas aktiviteteve , NP 2008 (emërtimi shkurt në anglisht - CPA 2008).

